




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. 2-D/DPK	Nr Prot. 01-4465/15
Dep. 03	Bi Prot. Prot No.
Nr. i faq.	Data 26.11.2015
Broj stranica	Datum
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	24.11.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPK 03-02-2668/15
PËR/ZA/TO:	z. Heset Mazreku – Avokat i Përgjithshëm Shtetëror
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik

I nderuari z. Mazreku,

Në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1 nën paragrafi 1.12) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 (paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 dhe 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me kërkesën tuaj për opinion, me numër protokoli DPKI 03-02-2668/15, për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të Anëtarit të Bordit të Ankesave të Agjencionit të Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale dhe ekspertit të Gjykatës në lëmin e punës, krahas ushtrimit të funksionit publik si Avokat i Përgjithshëm Shtetëror, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Ekziston papajtueshmëri në ushtrimin e funksionit si ekspert i Gjykatës, krahas ushtrimit të funksionit publik të Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror. Ndërsa, për ushtrimin e funksionit të Anëtarit të Bordit të Ankesave në Agjencionin e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, Ligji PKI nuk ka paraparë ndonjë ndalesë.

Arsyetim

Në bazë të Ligjit 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në tekstin e mëtejshëm: Ligji PKI), pozita e Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror, hynë në kategorinë e zyrtarëve të lartë publik.

Sipas këtij ligji, të gjithë zyrtarët e lartë publik kanë për obligim parandalimin e konfliktit të interesit dhe kanë për detyrë të zgjidhin vetë brenda afatit ligjor, dhe në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të tyre të interesit (neni 8, par. 1).

Ligji PKI parasheh edhe parimet e veprimit dhe mos veprimit të zyrtarit të lartë. Disa prej këtyre parimeve të parashikuara në këtë ligj janë se zyrtari i lartë, gjatë ushtrimit të funksionit publik, duhet të veprojë në mbrojtje të interesit publik dhe nuk ka të drejtë që interesin e tij privat ta vëre për interesin publik, për mbrojtjen e të cilit është zgjedhur apo emëruar. Pastaj, zyrtari i lartë duhet të kryej punën e tij me ndershmëri, ndërgjegje, paanshmëri, të ruajë autoritetin e zyrtarit të lartë dhe institucionit dhe me punën e tij të rrisë besimin e qytetarëve në institucione. Po ashtu zyrtari i lartë nuk duhet të lejoj që interesat e tij private të bien në konflikt me funksionin e tij. Ai duhet të shmang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, apo i mundshëm.

Ky ligj, në nenin 16 (pika 2) ka përcaktuar se:

“Zyrtari i lartë publik nuk mund të ushtrojë veprimtari private, si; avokatisë, noterisë, ekspert të licencuar, konsulent, agjent apo përfaqësues të organizatave të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni”.

Në bazë të kësaj dispozite, ju nuk mund të ushtroni njëkohësisht funksionin e ekspertit të Gjykatës dhe atë të zyrtarit të lartë publik.

Ndërsa për pozitën e Anëtarit të Bordit të Ankesave në Agjencionin e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale Ligji PKI nuk ka paraparë ndonjë ndalesë, përveç konfliktit “rast për rast” të interesit në ndonjë vendimmarrje të caktuar. Këto situata i ka rregulluar neni 13 i Ligjit PKI në të cilin parashihet:

1. Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij private lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit.

2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari i lartë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni mbikëqyrës. Deklarimi si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur.

3 . Vetë deklarimi si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari i lartë përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar.

Me respekt!

